



KOMPANIA KOSOVARE PËR DISTRIBUIM DHE FURNIZIM ME ENERGIJË ELEKTRIKE S.A.
KOSOVO ELECTRICITY DISTRIBUTION AND SUPPLY COMPANY J.S.C
KOSOVSKO PREDUZEĆE ZA DISTRIBUCIJU I SNABOVANJE ELEKTRICNOM ENERGIJOM D.O.O.
KEDS - SH.A.

Ndërtesa e Elektrokosovës
Bulevardi Bill Clinton nr.3
Prishtinë 10000
Republika e Kosovës

Elektrokosova Building
Bill Clinton Boulevard no.3
Prishtina 10 000
Republic of Kosovo



Nr. 11 Dt. 09.03.2016
HQ 2

Komentet e KEDS-it ndaj Raportit Konsultative të ZRrE-së Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin 2016

I. Hyrje

Ky dokument përmbledh komentet e KEDS-it ndaj Raportit Konsultativ (RK) të Rishikimit të Dhjetë të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE 10), të lëshuar më 24 shkurt 2016. Komentet e përmbledhura dhe çështjet kryesore janë përfshirë në këtë dokument.

KEDS falënderon ZRrE-në për dhënien e mundësisë për të ju përgjigjur çështjeve të rëndësishme të ngritura nga ZRrE-ja në këtë raport konsultativ dhe kërkon që pozita e KEDS-it në çështjet e ngritura të konsiderohet seriozisht para se të caktohen tarifat të cilat hyjnë në fuqi me 1 Prill 2016.

Si gjithmonë, KEDS është i gatshëm që në çdo kohë të takohet me ZRrE për t'i diskutuar çështjet e ngritura në RK. Për më tepër kalkulimet në formë elektronike të tabelave do t'i dorëzohen ZRrE-së, me qëllim që ZRrE t'i shfrytëzoj ato për nevojat e saj.

II. Balanca e Energjisë

Në përgjithësi, ZRrE-ja ka paraqitur saktësisht volumet e energjisë në shpërndarje si dhe ka përdorur nivelin e njëjtë të shitjeve në OSSh ashtu siç e ka parashikuar KEDS në aplikacionin e tij. Edhe pse KEDS nuk ka ndonjë kundërshtim serioz ndaj përshtatjeve të ZRrE-së, ne duhet të theksojmë se niveli i parashikuar i zvogëlimit të humbjeve në raportin konsultativ të saj nuk paraqet pritjet reale. KEDS në mënyrë të vazhdueshme ka informuar ZRrE-në që është duke u ndëshkuar për nivelin e humbjeve që nga viti 2013, të shkaktuara nga nën-performaca e mbajtësit paraprak të licencës në atë kohë. Ky ndëshkim prej 1.8% të nivelit të humbjeve në vazhdimësi është duke e bartur padrejtësisht tek KEDS.

Që nga fillimi, KEDS ka informuar zyrtarisht ZRrE-në, se pika fillestare për zvogëlimin e humbjeve prej 5% është jo-reale dhe e paarritshme, prandaj nuk ka qenë asnjëherë subjekt i diskutimeve gjatë përmblylljes së negociatave për privatizimin e funksioneve të shpërndarjes dhe furnizimit.

Në një ambient të shturur një ndëshkim i tillë e vështirëson edhe më shumë pozitën e KEDS-it si shpërndarës i energjisë elektrike. Në këto rrethana, KEDS me shumë respekt është duke kërkuar nga ZRrE-ja që këtë çështje ta merr parasysh gjatë përshtatjeve përfundimtare. Në tabelën në vijim është paraqitur qëndrimi i KEDS në Balancën e Energjisë për të reflektuar dallimin prej 1.8% të nivelit të humbjeve ndaj vlerësimit të ZRrE-së.



Balanca e Energjisë 2016			
Përshkrimi	KEDS	ZRrE	Diferenca
	GWh	GWh	
TC A (prodhimi ne prag)	1,983.4	1,983.4	-
TC B (prodhimi ne prag)	3,687.5	3,687.5	-
Rishikim i prodhimit te KEK	(120.0)	(120.0)	-
Per Termokos	(38.7)	(38.7)	-
Gjenerimi bruto	5,512.2	5,512.2	-
Ujmani dhe BRE tjera ne nivel të transmisionit	158.2	158.2	-
Hyrja ne transmision	5,670.4	5,670.4	-
Import	661.3	661.3	-
Ne diskonim	6,331.7	6,331.7	-
Konsumatoret 220/110 kV	677.2	677.2	-
Mihjet	121.0	121.0	-
Shpenzimi vet. nga Transmisioni	152.0	152.0	-
Rrjeti Distributiv	4,299.6	4,206.2	93.6
Konsumi neto-max	5,249.8	5,156.3	93.6
Humbjet ne bartje	114.0	114.0	-
Konsumi bruto	5,363.8	5,270.3	93.6
Eksporti	968	1,061.5	(93.6)
Teprica-Mungesa	-	-	-
Hyrja ne distribucion	4,299.6	4,206.2	93.6
Gjenerimi ne nivel te OSSH	64.2	64.2	-
Ne diskonim	4,364	4,270.4	93.5
Humbjet teknike dhe komerciale	924.3	830.9	93.5
Humbjet teknike dhe komerciale (%)	22.43%	20.63%	1.8%
Veriu	243.3	243.3	-
Shitjet ne OSSH	3,196.2	3,196.2	-
Total shitjet për FPEE	3,873.4	3,873.4	-

I. Kostoja e humbjeve në OSSH

KEDS në parim pajtohet me mënyrën e kalkulimit të kostove të humbjeve nga ZRrE, mirëpo gjatë analizimit të raportit konsultativ KEDS ka vërejtur një lëshim teknik nga ana e ZRrE-së dhe beson se i njëjti është bërë pa ndonjë qëllim dhe për këtë arsye kërkon korrigjimin e tij.

Pikat kryesore për të cilat KEDS mendon se duhet trajtuar gjatë kalkulimit të kostove të humbjeve janë:

1. Korrigjim lidhur me azhustimin e kostove të humbjeve për vitin paraprak e i cili kalkulohet duke aplikuar cakun e humbjeve të lejuara nga ZRrE sipas pjesë së dytë të shprehjes për kalkulimin e koston së humbjeve ($LSSC_{at-1} - LSSC_{t-1}$)
2. Niveli i rishikuar i caktit të humbjeve prej 1.8% i sqaruar në seksionin e Balancës së Energjisë.



Në tabelën në vijim është dhënë kalkulimi i kostove të humbjeve sipas qasjes së ZRrE-së (por duke përfshirë edhe azhustimin e vitit paraprak) dhe sipas kërkesës së KEDS për shqyrtimin e nivelit të humbjeve sipas formulës në vijmë:

$$LSSCt = LSSAt * REUEt * WHEAt + (LSSCat - 1 - LSSCft - 1) * (1 + It) + (LSSCat - 1 - LSACT - 1) * LSSFt$$

Qasja e ZRrE-së				
		ETR ₉ Lejuar	ETR ₉ Aktual	ETR ₁₀ Propozim
Humbjet e lejuara (LSSCt)				
Humbjet e lejuara				
LSSAt	%	23.1%	28.0%	20.6%
REUEt	GWh	4,232.1	4,429.97	4,027.1
WHEAt	€/MWh	28.2	29.23	34.0
LSSCat-1			28.94	
LSSCft-1		27.64		28.26
It	14.87%			
LSACT-1			35.06	
LSSFt				0
LSSCt		22.79		29.74
Qasja e KEDS				
		ETR ₉ Lejuar	ETR ₉ Actual	ETR ₁₀ Proposed
Humbjet e lejuara (LSSCt)				
Humbjet e lejuara				
LSSAt	%	23.1%	28.0%	22.4%
REUEt	GWh	4,232.1	4,430.0	4,120.5
WHEAt	€/MWh	28.24	29.23	34.01
LSSCat-1			28.94	
LSSCft-1		27.64		31.44
It	14.87%			
LSACT-1			35.06	
LSSFt				0
LSSCt		26.3		32.92



II. Kostot Operative

Gjatë analizimit të raportit konsultativ KEDS ka vërejtur se ZRrE ka përdorur faktorin e efikasitet ndaj total OPEX-it të aprovuar për vitin 2015, përkundër faktit se disa elemente të linjave në OPEX të cilat nuk ishin pjesë gjatë shqyrtimit periodik siç janë: kostot e sigurimit shëndetësor, kostot për sigurimin e aseteve, kostot e shturjes, janë fikse dhe si të tilla realizohen me kontrata të caktuara nuk duhet të jenë subjekt i përshtatjeve për faktorin e efikasitetit.

Bazuar në atë që u tha më lartë KEDS beson se duhet rishikuar propozimi fillestar për kostot e OPEX-it të propozuar nga në ZRrE nga 25.1mil€ në 25.6mil€.

III. Komponentët tjera

V.1 Kostot e përjashtuara

Në kuadër të rishikimit të kostove të operatorit të sistemit të shpërndarjes nga ana e ZRrE-së vërehet se kostot që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve të përjashtuara janë zbritur tërësisht gjatë përcaktimit të kostove të lejuara përkatësisht të hyrave të lejuara maksimale të OSSh-së.

Shërbimet e përjashtuara kanë të bëjnë me kyçjet e konsumatorëve të mëdhenj dhe konsumatorëve shtëpiak. Varësisht nga natyra e këtyre kostove të cilat mund të jenë operative apo kapitale duhet të bëhet korrigjimi i të hyrave. Natyra e kostove të konsumatorëve shtëpiak është përafërsisht e barabartë si e karakterit operativ po edhe atij kapital, përderisa kostot për kyçjen e konsumatorëve të mëdhenj mbulojnë kryesisht pjesë të CAPEX-it.

KEDS pajtohet me qasjen e ZRrE-së sa i përket reduktimit të kostove të OPEX-it, të cilat duhet reduktuar në tërësi në vitin e parë, përkatësisht të hyrat e mbuluara nga konsumatorët lidhur me ofrimin e shërbimeve që kanë mbuluar pjesë të OPEX-it gjatë vitit 2015 duhet zbritur në tërësi në vitin 2016. Mirëpo derisa mbulimi i kostove të CAPEX-it nga KEDS bëhet në pajtueshmëri me jetëgjatësinë e aseteve përkatëse, andaj edhe zbritja e këtyre kostove duhet bërë sipas të njëjtit parim dhe jo në tërësi. Pra nëse këto të hyra mbulojnë kosto vjetore të zhvlerësimit vetëm vlera vjetore e zhvlerësimit duhet zbritur dhe jo vlera totale e zhvlerësimit.

Në tabelën në vijim është paraqitur ndikimi i kostove të përjashtuara që kanë të bëjnë me OPEX dhe CAPEX gjatë vitit 2015:



Përshkrimi	Të hyrat	OPEX	Vitet	CAPEX	Zhvlërësimi	Kthimi	2015	2016	2017
	(€ '000)	(€ '000)		(€ '000)	(€ '000)	(€ '000)			
Shtëpiak	1,900	950	2015	950	48	111	1,109		
50% - 50%			2016	903	48	105		153	
			2017	855	48	100			147
			2018	808					
Konsumatorët e mëdhenjë	1,600	160	2015	1,440	72	168	400		
10% - 90%			2016	1,368	72	160		232	
			2017	1,296	72	151			223
			2018	1,224					
	3,500						1,509	385	370

Shënim: Zhvlërësimi 20 vite

Kthimi: 12%

Dëshirojmë të ritheksojmë se KEDS (OSSh) pret nga ZRrE që vlerën e zhvlërësimit dhe kthimit vjetor ta reduktoje vetëm për ndikimin vjetor të këtyre kostove dhe këtë reduktim ta korrigjojë gjatë përcaktimit përfundimtar të të hyrave të lejuara maksimale për OSSh-në për vitin 2016.

Për të hyrat që mund të rezultojnë nga ofrimi i këtyre shërbimeve në vitet në vijim KEDS kërkon që edhe këto të hyra të trajtohen sipas parimit të përshkruar më lartë deri në periudhën e ardhshme rregullative kur do të duhej të bëhej sqarimi ndërmjet kostove që duhet mbuluar nga ngarkesat DUOS dhe nga ngarkesat për kyçje. Për më tepër edhe të licencuarit e tjerë vazhdojnë të kenë të hyra të parregulluara, por për ta nuk është duke u aplikuar reduktimi i këtyre të hyrave gjatë përcaktimit të MAR-it të tyre, për të cilët gjithashtu besojmë se do të përshtaten në fund të periudhës rregullative.

Vlera përfundimtare e kostove të përjashtuara, duke përfshire edhe të hyrat e parregulluara prej 1.7mln€, të cilat duhet të reduktohen gjatë përcaktimit të MAR-it të OSSh-së për vitin 2016 është 3.2mln€.



V.2 Rikthimi i humbjeve

Në vlerësim e të hyrave të lejuara maksimale për OSSh-në ZRrE ka zbritur në total të hyrat që kanë të bëjnë me rikthimin e humbjeve. Lidhur me këtë çështje KEDS dëshiron të ngre shqetësimin e saj se jo e gjithë sasia e energjisë së faturuar si “ rikthimin i humbjeve” do të arkëtohet nga konsumatorët të cilëve i është lëshuar fatura për rikthimin e humbjeve për faktin se:

1. Konsumatorët mund të ankohen në instancë të parë në ZRrE dhe më pastaj edhe në Gjykatë, andaj varësisht nga vendimi final jo e gjithë energjia e faturuar për këtë qëllim mund të lejohet t’ju faturohet konsumatorëve, përkatësisht kjo paraqet një vlerë diskutabile dhe një procedurë të gjatë kolektimi.
2. Vetëm një vlerë e vogël, afro 20% e energjisë së faturuar në emër të rikthimit të humbjeve inkasohet.

Duke pasuar parasysh se natyra e këtyre kostove ka të bëjë kryesisht me keqpërdorimin e energjisë, kërkojmë nga ZRrE që të bëjë përshtatjet e MAR-it të OSSh-së lidhur me kostot që kanë të bëjnë me rikthimin e humbjeve, ngase përjashtimi në tërësi i këtyre kostove nga MAR-i i OSSh-së nuk paraqet më motiv për të për reduktimin e humbjeve që kanë ndodhur në të kaluarën.



VI. Të hyrat e lejuara maksimale për KEDS

Në tabelën në vijim është paraqitur MAR-i përfundimtar për KEDS-in, pasi të merren parasysh përshtatjet e nevojshme të sqaruara në seksionet më sipër.

MAR i OSSh		SHTE 10 RK	KEDS Propozimi
Parametrat e indeksimit			
It	%	14.87%	14.87%
Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes (OPMct)			
$OPMct = OPMct_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - Et) * (1 - Pt)$	€m	25.09	25.60
Zhvlerësimi i lejuar (DEPCt)			
$DEPCt = DEPCt_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - Pt)$	€m	8.75	8.75
Kthimi i lejuar (RTNct)			
$RTNct = RTNct_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - Pt)$	€m	14.22	14.22
Humbjet e lejuara (LSSct)			
LSSAt	%	20.63%	22.43%
REUet	GWh	4,027.1	4,120.5
WHEAt	€/MWh	34	34
LSSCat-1			
LSSCft-1		28.3	31.4
LSACT-1			
LSSct		23.63	32.92
Azhustimet			
Të hyrat e parregulluara	€m	-5.33	-3.25
KREV			
KREV	€m	4.33	5.13
MAR			
$MARt = OPMct + DEPCt + RTNct + LSSct + LICct + KREVt$	€m	74.94	83.65